



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 330 / Prot

Elbasan më 27 /01/2021

VENDIM

Nr. 27 datë 27 /01/2021.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin DHJETOR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin DHJETOR 102 familje me fond 264.800 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 331 / Prot

Elbasan më 27 /01/ 2021

VENDIM

Nr. 2 datë 27 /01/2021

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin DHJETOR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **DHJETOR 2020** gjithsej 206 familje me një fond prej 675.020 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr 332/prot
1

Elbasan më 27-01 2021

VENDIM
Nr. 3 datë 27/01/2021

Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkise

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/01/2021 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë si më poshtë:
1. Familje të varfëra të cilat janë refuzuar për shkaqe administrative nga sistemi i pikëzimit,
 2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
 3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar (apo në burg) dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat perkatës.
 4. Familje me probleme të tjera sociale.

- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë: Çertifikatë familjare, Fotokopje e kartës së identitetit, Vërtetime nga Adm.Njësisë a PSZ dhe formulari i paraqitjes mujore.
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas Udhezimit nr. 4 datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, për numrin faktik të anëtarëve të familjes.
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi



Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





131
27.1.2021



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 333 Prot

Elbasan më 27/01/2021

VENDIM
Nr. 24 datë 27/01/2021

**Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për
bllok-ndihmën ekonomike**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/01/2021 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”;

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
 2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
 4. Familje me shumë fëmijë
 5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune;
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë të njëjta me VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike



- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas Udhezimit nr. 4 datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi:

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





132

28.1.2021



9

334/1

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
KËSHILLI I BASHKISË**VENDIM**

Nr. 5 datë 28.01.21

28.01.21

“Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjetet motorike në administrim të “Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan” per vitin 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 28.01.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për mjetet motorike në administrim të “Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan”, per vitin 2021 sipas tabelës bashkëngjitur .
2. Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidencimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjeteve, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
3. Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për përballimin me fonde të buxhetit vendor të njësisë shpenzuese, të të gjitha shpenzimeve për karburant, pjesë këmbimi dhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera ligjore (kolaudimin, siguracionin, etj) për përdorimin normal të mjeteve motorike, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
4. Ngarkohet Drejtori i Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak**Klajdi GRIPSHI****Kryetar i Këshillit Bashkiak****Hektor Çiftja**



133
28.1.2021
SEKRETARIA
PREFEKTI QARAKULI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 306/ Prot.

Elbasan më, 28.01.2021

VENDIM

Nr. 6 datë 28.01.2021

***“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit,
zotit Ervin Saraçi”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____01.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ervin Saraçi”, mbështetur në nenin 54 (gërma “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ervin Saraçi, me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në pozicione të ndryshme kyçe në Bashkinë Elbasan, duke reflektuar një shkallë të lartë profesionalizmi, humanizmi, gadishmërie dhe vullnetarizmi, për të luajtur një rol të rëndësishëm në vetëqeverisjen vendore të këtij qyteti, duke lënë gjurmë në historikun e Bashkisë Elbasan, si një ndër zv/kryetarët më të suksesshëm të saj”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

(11.1)

KRYETARI

Hektor Çiftja

D. Kristo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 304/11 Prot.

Elbasan më, 27.01.2021

VENDIM

Nr. 7 datë 27.01.2021

***“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit,
zotit Jani Dode”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ .01.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Jani Dode”, mbështetur në nenin 54 (gërma “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Jani Dode, me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit si pedagog, studiues, hulumtues dhe metodist, duke reflektuar një shkallë të lartë profesionalizmi dhe duke lënë gjurmë në historikun e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si një ndër drejtuesit më të suksesshëm të saj”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

D. Kristo





57/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 308/11 Prot.

Elbasan më 27.01.2021

VENDIM

Nr. 8 datë 27.01.2021

***“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit,
zotit Ferdinand Shkrepa”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ .01.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ferdinand Shkrepa”, mbështetur në nenin 54 (gërma “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. T'i japë titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ferdinand Shkrepa, me motivacionin:
“Për kontributin e dhënë në fushën e mjekësisë dhe veçanërisht të okulistikës, duke treguar profesionalizëm dhe përkushtim”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

D. Kristo





64

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 305/1 Prot.

Elbasan, më 27.01.2021

VENDIM

Nr. 9 Datë : 27.01 /2021

“Mbyllje procedure privatizimi banesë shtetërore”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____. _____. _____. pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit), mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440 datë 04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”, Ligji Nr. 22/2018 “Për Strehim Social”, VKM nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndyshuar dhe të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”

VENDOSI:

- 1) Miraton “Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore” për qytetarin e mëposhtëm:
 - Qytetari Drita Qemal Blushi sipas certifikatës të gjëndjes familjare 01.12.1992, për privatizimin e apartamentit të përbërë nga një dhomë , ½ sallon, ½ banjo, të ndodhur në lagjen “Shënkoll”, pallati 116, shkalla C, kati 5, apartamenti nr.14, zona kadastrale 8522, Elbasan
 - Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM nr.179 datë 26.02.2020.
- 2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit).
- 3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



9

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 335 / Prot.
11

Datë 27.01. 2021

VENDIM

NR. 10, DATË 27. 01. 2021

MBI

**“VLERSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PER VITET
2022-2024**

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë 27. 01. 2021, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura administrata e Bashkia Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2022-2024”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Elbasan për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme 2022-2024, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETAR
Klajd GRIPSHI

KRYETAR
Hektor ÇIFTJA





11/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 436/11 Prot.

Elbasan më 27.01.2021

VENDIM

Nr. 13 datë: 27.01.2021

“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit” zotit Fatmir Musaj

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __.01.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit, zotit Fatmir Musaj”*, mbështetur në nenin 54 (gërma “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

VENDOSI:

4. T’i japë titullin “Qytetar Nderi” i Elbasanit, zotit **Fatmir Musaj**, me motivacionin:

“Për kontribute të vlefshme në fushën e artit, kulturës dhe arsimit, si shkrimtar, gazetar, studiues e arsimtar; i përkushtuar në studimin dhe evidentimin e vlerave të traditës dhe zakoneve të qytetit të Elbasanit”

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Kryetari i Keshillit Bashkiak.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

1111

KRYETARI

Hektor Çiftja

D. Kristo





3

142
27.1.2021
SHQIPËRI
QARKUT ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 453 Prot.

Elbasan, më 27.01.2021

V E N D I M

Nr. 15 Datë: 27.01.2021

“Mbi dhënie me qira (rinovim kontrate) të ambjentit “kuzhinë” në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Luigj Gurakuqi”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __.01.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar, V.K.B Nr. 145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”;

V E N D O S I:

1. Miraton dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit “kuzhinë” të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Luigj Gurakuqi” me nr. pasurie 7/93 ndodhur në Lagjen “Luigj Gurakuqi”, Z.K.8521 me sipërfaqe 153 m², për t’u përdorur për “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme profesionale” (Katering) të Bashkisë Elbasan, me tarifë qiraje mujore 1000 (njëmijë) lekë/m², subjektit “Olta Sharra” me afat 3 (tre) muaj nga data 25.01.2021 deri më 24.04.2021.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETAR
Klajd Gripshi

Ull

A.A

KRYETAR
Hektor Çiftja

